



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TE PRONES PUBLIKE

U R D H E R

Nr. 99 Date. 24 07.2002

Per

**Zmadhimin e Kapitalit Themeltar te
Sh.A "Ujesjellesi" Berat**

Ne baze te paragrafit te pare te nenit 2 te Ligjit Nr. 8237, date 01.09.1997 " Per disa ndryshime ne Ligjin Nr. 7926 , date 20.04.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve shtetore ne shoqeri tregtare" ndryshuar me Dekretin Nr.1195 date 14.08.1995, Ligjin Nr 8158, date 07.11.1996, ndryshuar me Dekretin Nr.3318, date 30.04.2002 Ligjin Nr. 8885, date 22.04.2002 dhe nenit 164 te Ligjit Nr.7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare", me cilesine e aksionerit te vetem

URDHEROJ:

Ne aktet e themelimit te Sh.A "Ujesjellesi" Berat te behen ndryshimet e meposhtme:

1. Kapitali Themeltar te zmadhohet per vleren e sektorit te kanalizimeve 25.796.448 leke e barabarte me 25.796,448 aksione me vlere nominale 1000 leke secili.
2. Kapitali Themeltar i Sh.A "Ujesjellesi" Berat te behet nga 474.679.552 leke ne 500.476.000 leke e barabarte me 500.476 aksione me vlere nominale 1000 leke secili.
Keto ndryshime te behen ne aktin e themelimit dhe ne statutin e shoqerise.
3. Ngarkohet Drejtoria e Administrimit te Prones Publike per kryerjen e veprimeve perkatese ne perputhje me parashikimet e nenit 33 te Ligjit Nr. 7667 date 28.01.1993 " Per regjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga Shoqerite Tregtare.

MINISTER

ERMELINDA MEKSI



RAPORT I EKSPERTEVE KONTABEL TE AUTORIZUAR

Objekti i Misionit :

Zmadhimin e kapitalit themeltar te shoqerise tregtare "Ujesjellesi" sh.a Berat si rezultat i transferimit te vlerave pasurore dhe rivlersimit te pasurise te Ndermarjes se Kanalizimeve Berat prane shoqerise tregtare Ujesjellsi Sh.A Berat ne zbatim te V.K.M. nr 194 date 20.03.1998

Ekspertet Kontabel te Autorizuar : Paqesor Qato Kastriot Haxhaj

Berat me 26/11 /2001

**EKSPERT KONTABEL
I AUTORIZUAR
PAQSOR QATO**

**RAPORT PER ZMADHIMIN E KAPITALIT THEMELTAR
TE SHOQERISE TREGTARE "UJESJELLSI" SH.A BERAT**

Ne zbatim te vendimit te te K.M Nr 194 date 20/03/1998 "Per kriteret e percaktimit te kapitalit themeltar te shoqerive shteterore qe do te krijohen nga shnderrimi i ndermarjeve shteterore ne shoqeri tregtare" ne kemi kryer misionin e ekspertimit kontabel per verifikimin dhe vlersimin e pasurive sipas aktit te transferimit nga Ndermarja Komunale Banesa Berat prane shoqerise tregtare "Ujesjellsi" Sh.A Berat dhe relatojme si vijon :

KONTROLLI I AKTIVEVE TE QENDRUESHME TE TRUPEZUARA

Bazuar ne dokumentat kontabel te marra ne dorezim per Sektorin e Kanalizimeve Berat sipas procesverbalit date 29.04.2000 rezulton se prane shoqerise tregtare "Ujesjellsi" Sh.A Berat jane marre ne dorezim vlerat pasurore sipas llogarive kontabile perkatese te mbeshtetura ne dokumentat inventariale si vijon :

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia	Cmimi	Vlera (kosto historike) ne lek
1	Aktive te qendrueshme te trupezuara				16 048 198
a	- Ndertesa	cop	1	245 520	245 520
b	- Autobot "Praga "	cop	1	85000	850 000
c	- Ford kamioncin	cop	1	650000	650 000
d	- Rrjeti K.U.Z		-	-	14 302 678
	Tubo betoni Ø 150- Ø1000	ml	45 855	-	-
	Qemer	ml	900	-	-
	Kuneta veshur me beton	ml	3538	-	-
	Tubo eterniti Ø - 279	ml	75	-	-
	Tubo gize Ø - 250	ml	245	-	-
2	Gjendje te inventarit ne proces				68 730
	- Inventar i imet ne perdorim	-	-	68730	68 730
	Totali i vlerave pasurore				16 116 928

Theksojme se per vlerat e mesiperme pasurore mungojne te dhenat kontabile ndaj ne baze te V.K.M. nr 194 date 20.03.1998 si dhe te udhezimit nr 1 date 15.05.1998 kapitulli III pika c ,vlera aktuale e aktiveve te qendrueshme te trupezuara eshte percaktuar nga nje komision ekspertesh vleresues sic eshte parashikuar ne V.K.M nr 192 date 20.03.1998.

**EKSPEHT KONTABEL
I AUTORIZUAR
PAQSOR QATO**

Per vlersimin e truallit :

Ne baze te akt vlersimit te truallit te miratuar nga Keshilli i Qarkut Berat sektori i urbanistikes rezulton se qendra e sektorit te kanalizimeve me nje siperfaqje trualli 40 m2 eshte vleresuar me cmimin 720 lek/m2 dhe ne total vlera truallit vijon 28 800 leke . Kjo vlere justifikohet me dokumentacionin kontabel ligjor .

Per vleresimin e nderteses :

Meqenese mungojne te dhenat kontabile vlersimi i nderteses eshte bere me komision ekspertesh te vlersimit te pasurive te paluajteshme si eshte parashikuar ne V.K.M nr 192 date 20.03.1998 Ne baze te raportit te eksperteve te vlersimit te pasurise se paluajteshme date 30.09.2001 vlera e nderteses eshte percaktuar 245520 leke .Per ndertesën zbatohet koeficienti i vendodhjes me 50 % shtese meqenese ndodhet brendavijave kufizuese te qytetit dhe rezulton vlera perfundimtare e nderteses 368 280 leke .

Per vlersimin e mjeteve te transportit :

Komisioni ne vlersimin e mjeteve te transportit ka gjykuar dhe vlersuar secilin automjet dhe konkretisht ne baze te certifikates se vlersimit te hartuar nga ekspertet e vlersimit te pasurise date 30.09.2001 rezulton se se vlera e automjetit te transportit autobot tip Praga vleresohet me 773 500 leke dhe per mjetin e transportit Ford kamioncin ekspertet e pasurise e kane gjykuar dhe vlersuar ate me vleren aktuale te tregut per 611 00 leke

Per vleresimin e rrjetit te K.U.Z :

Meqenese mungojne te dhenat kontabile vlersimi i rrjetit te kanalizimeve te ujrave te zeza eshte bere me komision ekspertesh te vlersimit te pasurive te paluajteshme sic eshte parashikuar ne V.K.M nr 192 date 20.03.1998 Ne baze te raportit te eksperteve te vlersimit te pasurise se paluajteshme date 30.09.2001 vlera e rrjetit te kanaleve te ujrave te zeza eshte percaktuar 25 670 000 leke.

Per vlersimin e inventarit te imet :

Ne vlersimin e inventarit te imet komisioni eshte nisur ne baze te vleres kontabile dhe ka gjykuar se vlera e inventarit te imet ne perdorim eshte vlera

**..... KONTABEL
I AUTORIZUAR
PAQSOR QATO**

aktuale e tij .Nuk rezultojne vlera stok ose jashte perdorimit te inventarit te imet ne perdorim .Pra vlera aktuale e tij per inventarin imet eshte 68 730 leke .

Ne percaktimin e kapitalit themeltar eshte vepruar ne baze te V.K.M nr 194 date 20/03/1998 .Te gjitha shtesat dhe pakesimet ne kapitalin themeltar per efekt te transferimit dhe vleresimit te pasurise te Sektorit te Kanalizimeve te Ndermarjes Komunale Banesa Berat jane pasqyruar ne formularin e llogarise nr 171 “ Efekte mbi kapitalin ” bashkangjitur ketij raporti te cilat u kontrolluan nga ana jone dhe gjykuam se ato jane te sakta.

Pra kapitali themeltar i sektorit te kanalizimeve Berat ne momentin e transferimit prane shoqerise “Ujesjellesi ”Sh.a Berat rezulton si vijon :

- Kapitali themeltar fillestar i transferuar 15 998 948 leke
- Shtese kapitali rivlersimi (Efekte mbi kapitalin 171) 9 797 500 leke
- Totali i kapitalit pas rivlersimi i transferuar 25 796 448 leke

Shoqeria tregtare “Ujesjellesi” Sh.A Berat eshte rregjistruar ne gjykatën e rrethit Tirane me nje kapital themeltar 474 679 552 leke e barabarte me 474 679 aksione me vlere nominale 1000 leke per nje aksion

Zmadhimit te kapitalit themeltar te shoqerise tregtare “Ujesjellesi” Sh.A Berat si rezultat i transferimit dhe i rivlersimit te kontributeve ne natyre nga sektori i Kanalizimeve prane Ujesjellesit sh.a Berat do te kryhet nepermjet emetimit te aksioneve te reja duke ruajtur te njeten vlere nominale 1000 leke per nje aksion

Pra kapitali themeltar i shoqerise “Ujesjellesi” Sh.A Berat ishte 474 679 552 leke e cili zmadhohet me 25 796 448 leke dhe vlera e kapitalit te nenshkruar pas zmadhimit te kapitalit rezulton 500 476 000 leke e barabarte me 500 476 aksione me vlere noninamle 1000 leke per nje aksion .

Ekspertet Kontabel te Autorizuar

Paqesor Qato

Kastriot Haxhaj


EKSPERT KONTABEL
I AUTORIZUAR
PAQSOR QATO

EKSPERT KONTABEL
I AUTORIZUAR
KASTRIOT HAXHAJ



Berat me 26/11/2004

Vleresimi i pasurise per Sektorin e Kanalizimeve te Ndermarjes Komunale Banesa Berat transferuar prane Ujesjellesi Sh.a Berat

Nr	Emertimi	Viti ne shrytezim	Njesia	Sasia	Vitet ne perdorim	Vlera fillestare kontabel	Amortizimi kontabel i akumuluar	Vlera e mbetur kontabel	Amortizimi kontabel i logartur me komision	Indeksi i vlersimit	Vlera aktuale minimale e percaktuar me eksperte vlersues (per ndertesen *50%)	Amortizimi i rivlersuar	Diferenca rivlersimi	
													Vlera fillestare	Amortizimi
1	Ndertesa	Dhjetor 1998	cop	1	-	245520	2480	243040			369280	0	125240	0
	Autobot tip		cop	1	-	850000	76500	773500			773500		0	0
	Ford kamioncine		cop	1	-	650000	39000	611000			611000		0	0
4	Rqjeti K.U.Z					14302678		14302678			25670000	0	11367322	0
	A.Q.T.					16048198	117980	15930218	0	0	27422780	0	11492562	-
5	Inventar i imet					68730		68730	0	0	68730	0	0	0
						16116928	117980	15998948	0	0	27491510	0	11492562	0
6	Trualli		m2	40			0	0	0	0	28800	-	28800	-
	Gjithsej					16116928	117980	15998948	0	0	27520310	0	11521362	0

**EKSPERT KONTABEL
I AUTORIZUAR
PAOSOR QATO**

VEPRIMET KONTABILE ME LLOGARINE 171 "EFEKTE MBI KAPITALIN "

Nr	VEPRIMI	Llogari qe debitohen		Llogari qe kreditohen	
		Nr. Llogarise	Vlera ne leke	Nr. Llogarise	Vlera ne leke
1	Rezerva e zhvillimit te trasheguar nga vitet e meparshme	111	-	171	0
2	Rezerva e shperblimit suplementar	112	-	171	0
3	Rezerva te tjera	118	-	171	0
4	Humbeje e mbartur dhe humbeje te vitit 1997	171	0	107	0
				121	0
5	Subvencione per investime i mbartur	131	0	171	0
6	Diferenca e rivlersimit te aktiveve te qendrueshme te trupezuara				
	- Shtesa e vleres fillestare	21	11492562	171	11492562
	- Shtesa e amortizimit	171	0	281	0
7	Zbritje 15 % e diferences midis amortizimit kontabel te akumuluar	171	1723862	105	1723862
8	Sistemimi i diferences midis amortizimit kontabel te akumuluar dhe amortizimit te llogaritur per rivlersim ,te aktiveve te qendrueshme te trupezuara	171	0		
9	Kontabilizimi i veprimeve te truallit	21	28800	171	28800
10	Mungesat fizike te aktiveve te qendrueshme te trupezuara qe nuk ka pergjegjesi materiale (Vlera fillestare -minus amortizim .)	281	0		0
		171	0	21	0
11	Mbyllja e llogarise 171	171	9797500	101	9797500
			23042724		23042724

I KONTABILES
 I AUTORIZUAR
 PAOSOR DATO



REPUBLIKA E SHQIPERISE
SH.A. UJESJELLESI BERAT – KUÇOVË
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E AKSIONARËVE

V E N D I M

Nr. 1/1, Datë 24.02 2017

Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve e Shoqërisë "Ujësllës Berat-Kuçovë" sh.a, me pjesmarrjen e aksionareve Bashkia Berat dhe Bashkia Kuçovë, pasi plotesojnë kuorumin dhe shumicën vendimarrëse për vendimet e zmadhimit ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, bazuar në ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqërite tregtare" i ndryshuar dhe në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.63, datë 27.01.2016 "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura",

V E N D O S I

- 1) Miratimin e raportit të ekspertëve kontabël për zvogëlimin e kapitalit të regjistruar të shoqërisë "Ujësllësi Berat-Kuçovë" sh.a, të caktuar me vendimin e Asamblesë së Përgjithëshme të aksionarëve, Nr.28, datë 05.12.2016.
- 2) Të zvogelojë kapitalin e regjistruar të shoqërisë me 43,041 aksione, me vlerë të përgjithëshme 43,041,000 lekë. Largohet si aksionar i shoqërisë "Ujësllësi Berat-Kuçovë" sh.a, Aksionari-Bashkia Poliçan, kundrejt likuidimit të aksioneve me vlerën e drejte të aktiveve materiale dhe financiare të transferuara.
- 3) Pas operacionit të mësipërm kapitali i regjistruar i shoqërisë "Ujësllësi Berat-Kuçovë" sh.a do të jetë 620,873,000 lekë i ndarë në 620,873 aksione me vlerë nominale 1000 lekë për aksion dhe zotërohet nga aksionarët:
 - Aksionari Bashkia Berat, zotëron 457,435 aksione, me vlerë të përgjithëshme 457,435,000 lekë, e cila përbën 73,68% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.
 - Aksionari Bashkia Kuçovë, zotëron 163.438 aksione, me vlerë të përgjithëshme 163,438,000 lekë, e cila përbën 26,32% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.
- 4) Të miratojë statutin e ri të shoqërisë i cili është hartuar në përputhje me statutin tip të përcaktuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.63, datë 27.01.2016 "Për riorganizimin

e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura".

6. Të ngarkojë administratorin e shoqërisë, për depozitimin e këtij vendimi në regjistrin tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit(QKB).

**ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E AKSIONARËVE E SHOQËRISË
"UJËSJELLESI BERAT-KUÇOVË" SHA**

Aksionarët pjesëmarrës

Për Bashkinë Berat
Kryetari i Bashkisë
Petrit SINAJ



Për Bashkinë Kuçovë
Kryetari i Bashkisë
Sëlfo KAPLLANI





REPUBLIKA E SHQIPERISE
QENDRA E REGJISTRIMIT TE AKSIONEVE SH.A.
TIRANE

EKSTRAKTI I REGJISTRIT TE AKSIONEVE

SH.A. Ujesjellesi Berat-Kuçove - BERAT

Gjendja më datë 04.10.2017
Kapitali themeltar 620.873.000 LEK
Vlera nominale / aksion 1.000 LEK
Totali i Aksioneve 620,873
Numri i Aksionerëve 2
Numri i Aksioneve të mbetura .. 0

Për QRA

ARDIAN MYSLIMAJ
"P"



Adresa: Rt. "George W. Bush" Nr.13
Kulla Postare: 7424 - Tiranë
Tel: ++355 / 4 / 233425
Fax / Modem: ++355 / 4 / 233442

Vendimi i Gjykatës: Nr. 14253 Dt. 21/03/96
Kodi Fiskal: K314 22103G
Nr. Llogarisë: 0200 355
BKT Dega Nr.2 Tiranë

NR.	EMRI	ATESIA	MBIEMRI	LINDUR ME	VENDLINDJA	AKSIONE	%	ADRESA	QYTETI	RRETHI
1	BASHKIA	-	KUÇOVE	01.01.2001	KUÇOVE	163.438	26.324%		KUÇOVE	KV
2	BASHKIA	-	BERAT	01.01.2001	BERAT	457.435	73.676%		BERAT	BR
TOTALI =						620.873	100.000%			

Numri i Aksionerëve : 2

Numri i faqeve: 2



REPUBLIKA E SHQIPERISE
SH.A. UJESJELLESI BERAT – KUÇOVË
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E AKSIONARËVE

VENDIM
Nr. 1/2 Datë 24.02.2017

Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve e Shoqërisë "Ujësjetllës Berat-Kuçovë" sh.a, me pjesmarrjen e aksionarëve Bashkia Berat dhe Bashkia Kuçovë, pasi plotesojnë kuorumin dhe shumicën vendimarrëse për vendimet e zmadhimit ose zvogëlimit të kapitalit të regjistruar, bazuar në ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqërite tregtare" i ndryshuar dhe në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.63, datë 27.01.2016 "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura",

VENDOSI

1. Miratimin e raportit të ekspertëve kontabël për zmadhimin e kapitalit të regjistruar të shoqërisë "Ujësjetllës Berat-Kuçovë" sh.a, të caktuar me vendimin e Asamblesë së Përgjithëshme të Aksionarëve, Nr.28, datë 05.12.2016.
2. Të zmadhojë kapitalin e regjistruar të shoqërisë "Ujësjetllës Berat-Kuçovë" sh.a, për 262,212 aksione, me vlerë nominale 1,000 lekë për aksion dhe vlerë të përgjithëshme 262,212,000 lekë si kontribut në natyrë i bashkisë Berat e Kuçovë nga transferimi i aseteve të ish njësive vendore. Në bazë të vlerave të aktiveve materiale të ish njësive vendore të shkruara sipas, vendëndodhjes teritoriale të tyre në bashkitë përkatëse, të transferuara në shoqërinë "Ujësjetllës Berat-Kuçovë" sh.a., Aksionari-Bashkia Berat përfiton 119,418 aksione, me vlerë të përgjithëshme 119,418,000 lekë dhe Aksionari-Bashkia Kuçovë, 142,794 aksione, me vlerë të përgjithëshme 142,794,000 lekë.
3. Pas operacionit të zmadhimit, kapitali i regjistruar i shoqërisë "Ujësjetllës Berat-Kuçovë" sh.a do të jetë 883,085,000 lekë i ndarë në 883,085 aksione me vlerë nominale 1,000 lekë për aksion dhe zotërohet nga aksionarët:
 - Aksionari Bashkia Berat, zotëron 576,853 aksione, me vlerë të përgjithëshme 576,853,000 lekë, e cila përbën 65.32% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.
 - Aksionari Bashkia Kuçovë, zotëron 306,232 aksione, me vlerë të përgjithëshme 306,232,000 lekë, e cila përbën 34.68% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.

4. Të ngarkojë administratorin e shoqërisë, për depozitimin e këtij vendimi në regjistrin tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit(QKB).

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E AKSIONARËVE E SHOQËRISË
"UJËSJELLESI BERAT-KUÇOVË" SHA

Aksionarët pjesëmarrës

Për Bashkinë Berat
Kryetari i Bashkisë
Petrit SINAJ



Për Bashkinë Kuçovë
Kryetari i Bashkisë
Selfo KAPLLANI





REPUBLIKA E SHQIPERISE
SH.A. UJESJELLES I BERAT – KUÇOVË
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E AKSIONARËVE

V E N D I M

Nr. 5, Datë 26.07 2017

Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve e Shoqërisë "Ujësjetllësi Berat-Kuçovë" sh.a, me pjesmarrjen e aksionarëve Bashkia Berat dhe Bashkia Kuçovë, bazuar në ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar,

V E N D O S I

- 1) Miratimin e raportit të ekspertëve kontabël për zvogëlimin e kapitalit të regjistruar të shoqërisë "Ujësjetllësi Berat-Kuçovë" sh.a, të caktuar me vendimin e Asamblesë së Përgjithëshme të Aksionarëve, Nr.3, datë 28.06.2017.
- 2) Si rrjedhojë e kalimit për privatizim të objektit "Zyrat e sh.a. Ujësjetllësi Berat-Kuçovë" me numër pasurie 8/71 zona kadastrale 8502 me sipërfaqe 235 m2 të zvogëlojë kapitalin e regjistruar të shoqërisë me 6,225 aksione, me vlerë të përgjithshme 6,255,000 lekë. Aksionarit Bashkia Berat i zvogëlohen 4,066 aksione ose 4,066,000 lekë dhe Aksionarit Bashkia Kuçovë i zvogëlohen 2,159 aksione ose 2,159,000 lekë.
- 3) Pas operacionit të mësipërm kapitali i regjistruar i shoqërisë "Ujësjetllësi Berat-Kuçovë" sh.a do të jetë 876,860,000 lekë i ndarë në 870,860 aksione me vlerë nominale 1000 lekë për aksion dhe zotërohet nga aksionarët:
 - Aksionari Bashkia Berat, zotëron 572,787 aksione, me vlerë të përgjithshme 572,787,000 lekë, e cila përbën 65,32 % të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.
 - Aksionari Bashkia Kuçovë, zotëron 304,073 aksione, me vlerë të përgjithshme 304,073,000 lekë, e cila përbën 34,68 32% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.

- 4) Të ngarkojë administratorin e shoqërisë, për depozitimin e këtij vendimi në regjistrin tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit(QKB)

**ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E AKSIONARËVE E SHOQËRISË
"UJËSJELLËSI BERAT-KUÇOVË" SHA**

**Për Bashkinë Berat
Kryetari i Bashkisë
Petrit SINAJ**



**Për Bashkinë Kuçovë
Kryetari i Bashkisë
Selfo KAPLLANI**



Ekspert kontabël i regjistruar

Dhimo Dundo
Ujçenca profesionale
Nr.8, datë 11.01.2000
Adresa: Godine pas ish "Shtëpia e ushtarakeve" Berat
Cel: 069 20 99 203
Tel/fax: (032) 238360
E-mail: dhimo.dundo@hotmail.com

AS-Audit Services sh.p.k

Adresa: Rr. "KOSOVAREVE", Nd.35, H.2, Ap.7
Njësia Administrative Nr.5, 1001, Tiranë
Mobil: 069 20 99 204
Tel/fax: (04) 2 430 084
E-mail: as-audit@hotmial.com
afirm.suli@hotmail.com

Berat më, 17.07.2017

Raport i ekspertit kontabël për zvogëlimin e kapitalit të regjistruar të shoqërisë "Ujësllësi Berat-Kuçovë" sh.a

Drejtuar: Aksionarëve të shoqërisë "Ujësllësi Berat-Kuçovë" sh.a

Të nderuar Aksionar,

Ne audituesit ligjor Dhimo Dundo dhe Afrim Suli, mbajtës të licencave profesionale, përkatësisht Nr.8, datë 11.01.2000 dhe Nr.4, datë 11.01.2000, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionareve të "Ujësllësi Berat-Kuçovë" sh.a, Nr.3, datë 28.06.2017, jemi caktuar me cilesinë e ekspertit kontabël për operacionin e zvogëlimin të kapitalit të regjistruar të shoqërisë si rrjedhojë e përfshirjes në proces privatizimi të objektit "Zyrat e sh.a. Ujësllësi Berat-Kuçovë".

Qëllimi angazhimit

Angazhimi ka si qëllim që në përputhje me ligjin "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, dhe vendimin e aksionarëve për zvogëlimin e kapitalit të regjistruar:

- I. Të verifikojmë vlerën e aktivitetit "Zyrat e sh.a. Ujësllësi Berat-Kuçovë" që do të hiqen shoqërisë "Ujësllësi Berat-Kuçovë" sh.a, si rrjedhojë e kalimit në proces privatizimi të tyre.
- II. Të përcaktojmë numrin dhe vlerën e aksioneve që rezultojnë nga zvogëlimi i kapitalit të regjistruar.

Kriteret e vlerësimit të çështjes dhe burimet e informacionit

Vlerësimet dhe gjykimet e çështjes bazohen në:

- Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar;
- Vendimin e asamblesë së përgjithshme të "Ujësllësi Berat-Kuçovë" sh.a,
- Vendimin Nr.3 datë 31.01.2017 të Këshillit Bashkiak Berat "Për miratimin e Përfshirjes në Proces Privatizimi të objektit "Zyrat e sh.a. Ujësllësi Berat-Kuçovë".
- Letrën e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes Nr.1292/1 Prot. datë 25.05.2017.
- Legjislacioni kontabël, standardet etike e profesionale etj.

Faqe 1

Përshkrim i shkurtër i shoqërisë

Shoqëria tregtare "Ujësllësi Berat-Kuçovë" sh.a, është e themeluar si person juridik me 01 Korrik 1996, në formën ligjore shoqëri aksionare dhe identifikohet në regjistrin tregëtar (CKB) me NUIS - in, J62903166T.

Kapitali i regjistruar i saj ne datën e këtij raporti, është 883,085,000 lekë, i ndarë në 883,085 aksione, me vlerë nominale 1.000 lekë për aksion dhe zotërohet nga aksionarët: Bashkia Berat zotëron 576,853 aksione ose 65.32 % të kapitalit të regjistruar dhe Bashkia Kuçovë zotëron 306,232 aksione ose 34,68 % kapitalit të regjistruar .

Me vendimin e Këshillit Bashkiak, Berat, nr.3 datë 31.01.2017, vendimin e Asamblesë së Aksionareve të shoqërisë "Ujësllësi Berat-Kuçovë" sh.a dhe shkresës së Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, nr.1292/1 Prot. datë 25.05.2017, është vendosur përfshirja në proces privatizimi e objektit "Zyrat e sh.a. Ujësllësi Berat-Kuçovë" dhe fillimi i procedurave të zvogëlimin të kapitalit.

Nga të dhenat e regjistrit të AAM-ve, të vertetimit nga dokumenti hipotekor dhe të kontabilitetit të shoqërisë rezultojnë se objekti "Zyrat e sh.a. Ujësllësi Berat-Kuçovë" me numër pasurie 8/71, zona kadastrale 8502 ka një sipërfaqe 235 m², vlerë historike 9,195,226 lekë, amortizimi i akumuluar është 2,970,226 lekë dhe vlera e mbetur është 6.225.000 lekë.

Mbi keto informacione dhe të tjera që u çmuan të nevojshme për angazhimin, në bazë të hapave të ndërmara e të punës së kryer, ne jemi në gjëndje tu bëjmë të njohur përfundimet që vijojnë:

Zvogëlimi i kapitalit

Në vendimin e Asamblese së Aksionarëve të cituar më sipër, është vendosur unanimisht që për objektin e futur ne proces privatizimi që të kryhen procedurat e nevojshme të zvogëlimin të kapitalit, duke bërë dhe reflektimet e nevojshme të këtyre ndryshimeve në dokumentacionin ligjor të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit plotëson kushtet paraprake të kërkuara nga legjislacioni tregtar dhe nuk paraqet rreziqe për kreditorët.

Ky zvogëlim shoqërohet me transferimin të aktiveve që janë pronë e shoqërisë, kundrejt heqjes dorë nga aksionet të aksionareve të saj, pa kundërshtpërbim, në përpjestim me aksionet që zotërojnë aktualisht.

Përcaktimi i vlerës dhe metodës së zvogëlimin

Vlera e aktivitetit që do të kalojë në procesin e privatizimit, do të vlerësohet me vlerën kontabël neto, pasi kjo është vlera që shoqëria pakëson nga pasuria e saj duke zvogëluar gjithashtu dhe kapitalin e regjistruar.

Vlera kontabël neto sipas Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit - të përmirësuara përkufizohet: "Vlera kontabël neto është shuma me të cilën një aktiv njihet në pasqyrën e pozicionit financiar (pasi zbritet amortizimi i akumuluar dhe humbjet e mundshme nga zhvlerësimi)".

Mbi bazen e të dhënave të kontabilitetit, zvogelimi i kapitalit do të behet për shumën 6.225.000 lekë, nëpërmjet zvogëlimin të numrit të aksioneve.

Faqe 2

Përcaktimi i ndryshimeve në aksionet dhe aksionarët e shoqërisë nga realizimi i operacionit të zvogëlimin të kapitalit të regjistruar.

Nga verifikimi i Ekstraktit të Regjistrin Tregtar të shoqërisë "Ujësllësi Berat-Kuçovë" sh.a, rezultojnë se kapitali i regjistruar i saj aktualisht është 883,085,000 lekë, i ndarë në 883,085 aksione, me vlerë nominale 1.000 lekë për aksion dhe zotërohet nga aksionarët: Bashkia Berat zotëron 576,853 aksione ose 65.32 % të kapitalit të regjistruar dhe Bashkia Kuçovë zotëron 306,232 aksione ose 34,68 % kapitalit të regjistruar.

Si rrjedhojë e kalimit për privatizim të objektit "Zyrat e sh.a. Ujësllësi Berat-Kuçovë" kapitali i regjistruar i shoqërisë "Ujësllësi Berat-Kuçovë" sh.a. do të zvogëlohet për 6,225,000 lekë i ndarë për çdo aksionar në përpjestim me përqindjen që ata zotërojnë në kapitalin e shoqërisë.

Pas operacionit të zvogëlimin të kapitalit i regjistruar i shoqërisë "Ujësllësi Berat-Kuçovë" sh.a do të jetë 876,860,000 lekë i ndarë në 876,860 aksione me vlerë nominale 1000 lekë për aksion dhe do të zotërohet nga aksionarët Bashkia Berat do të zotërojë 572,787 aksione ose 65.32 % të kapitalit të regjistruar dhe Bashkia Kuçovë do të zotërojë 304,073 aksione ose 34,68 % kapitalit të regjistruar

Opinion

Në përfundim të verifikimeve që kemi kryer, arrijmë në konkluzionin se:

- 1) Kapitali i regjistruar i shoqërisë "Ujësllësi Berat-Kuçovë" sh.a, si rrjedhojë e kalimit për privatizim të objektit "Zyrat e sh.a. Ujësllësi Berat-Kuçovë" me numër pasurie 8/71 zona kadastrale 8502 me sipërfaqe 235 m², zvogëlohet me 6,225 aksione, me vlerë të përgjithshme 6,225,000 lekë. Aksionarit Bashkia Berat i zvogëlohen 4,066 aksione ose 4,066,000 lekë dhe Aksionarit Bashkia Kuçovë i zvogëlohen 2,159 aksione ose 2,159,000 lekë.
- 2) Pas operacionit të zvogëlimin të kapitalit i regjistruar i shoqërisë "Ujësllësi Berat-Kuçovë" sh.a do të jetë 876,860,000 lekë i ndarë në 876,860 aksione me vlerë nominale 1.000 lekë për aksion dhe zotërohet nga aksionarët:
 - Aksionari Bashkia Berat, zotëron 572,787 aksione, me vlerë të përgjithshme 572,787,000 lekë, e cila përbën 65,32 % të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.
 - Aksionari Bashkia Kuçovë, zotëron 304,073 aksione, me vlerë të përgjithshme 304,073,000 lekë, e cila përbën 34,68 % të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.

Audituesi Ligjor

Dhimo Dundo

Për AS-Audit Services sh.p.k

Afrim Suli-Auditues Ligjor

Faqe 3